

VENDIM
Nr.106, datë 26.2.2010

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË NJË AUTOKOLONE USHTARAKE SLOVENE,
PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16 pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në datën 26 shkurt 2010, në itinerarin porti i Durrësit-Qafë-Thanë të 1 (një) autokolone ushtarake sllovene, të përbërë nga 2 (dy) automjete dhe 4 (katër) trupa të armatosur.

2. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën ushtarake sllovene, të jetë porti i Durrësit dhe pika e daljes të jetë pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

3. Autokolona ushtarake sllovene, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, të shoqërohet nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha